



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 723 Akti

Nr. 751 Vendim  
Tiranë, më 28.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                            |                 |
|----------------------------|-----------------|
| <b>Olsi Komici</b>         | <b>Kryesues</b> |
| <b>Valbona Sanxhaktari</b> | <b>Relatore</b> |
| <b>Firdes Shuli</b>        | <b>Anëtare</b>  |

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, në datën 26.3.2024, ora 12:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), në Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Aurel Celibashi**, me detyrë ndihmës ligjor, aktualisht pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i pranishëm në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Valbona Sanxhaktari dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Aurel Celibashi është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të funksionit të tij si ndihmës ligjor. Aktualisht, ai e ushtron këtë funksion pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, me përbërje si më lart në këtë vendim.
2. Me vendimin e datës 15.1.2021 është vendosur kryesues komisioner Olsi Komici, është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, si dhe fillimi i hetimit administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.
3. Në vijim, subjekti i rivlerësimit është njoftuar mbi përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
4. Nga relatorja janë administruar, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Gjatë hetimit administrativ është komunikuar nëpërmjet komunikimit elektronik me subjektin e rivlerësimit, ku iu dërgua pyetësi i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera në vijim gjatë hetimit administrativ, të cilat u administruan në dosje.
5. Trupi gjykues i mbledhur në datën 8.3.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes e, në vijim, pas diskutimeve vendosi: (a) përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Aurel Celibashi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera, thirrjen e dëshmitarit, afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta, si dhe të paraqesë parashtrimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e administruara në dosjen e hetimit duke marrë një kopje të saj. Në vijim brenda afatit të caktuar nga Komisioni, paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me rezultatet e hetimit.
7. Më tej, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ftoi subjektin e rivlerësimit Aurel Celibashi për t’u paraqitur në seancë dëgjimore në datën 26.3.2024, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0.
8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 26.3.2024, ora 12:00, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

9. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në këtë seancë dëgjimore publike. Gjatë kësaj seance dëgjimore, ai parashtrori qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për z. Aurel Celibashi në seancën e datës 28.3.2024, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

## II. PROCESI I RIVLERËSIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision AKSIK, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- ç) dokumentet shpresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- e) denoncimet nga publiku.

13. Lidhur me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit Aurel Celibashi trupi gjykues vëren se ai ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ subjekti Aurel Celibashi ka komunikuar me Komisionin në mënyrë korrekte dhe brenda afateve të përcaktuara.

### A. VLERËSIMI I PASURISË

14. Subjekti i deklaramit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

15. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 86/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*

➤ *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**16.** Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>2</sup>.

**17.** Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Aurel Celibashi iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar nga Komisioni.

**18.** Në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

**19. Mbi adresat e deklaruara të banimit.** Rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përbërjen familjare sipas certifikatës së gjendjes civile, ku rezulton i vetëm. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është shkëputur nga përbërja familjare me prindërit në datën 7.1.2015.

**19.1** Komisioni hetoi mbi përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit, bazuar në informacionin e dokumentacionin e administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mbi të gjithë përbërësit e gjendjes civile ndër vite (përfshirë regjistrim dhe ndryshim të vendbanimit, procesverbal për bashkim dhe veçim familjar, etj.), të vërtetuara e dokumentuara sipas dokumenteve bazë që mban e lëshon shërbimi i gjendjes civile.

**19.2** Komisioni verifikoi mbi adresat e banimit ndër vite, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësor, nga ku nuk rezultuan problematika për hetime më të thelluara.

**19.3** Në lidhje me apartamentin e prindërve të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar si adresë banimi prej tij, nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK Tirana Veri<sup>1</sup>, rezulton se:

**i)** Në emër të shtetasit A. C. figuron e regjistruar pasuria apartament, me sip. 63.00 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, pajisur me Certifikatë Pronësie nr. \*\*\*, datë 12.7.2017, regjistruar me nr. pasurie \*\*\*+\*\*\*-\*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë.

**ii)** Babai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi A. A. C., e ka përfituar pasurinë apartament 1+1, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, sipas Kontratës së Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.2.2009, me shitës shtetasin Gj. P. në shumën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, shumë e cila pasqyrohet e likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës. Shtetasi Gj. P. e ka përfituar pasurinë apartament në cilësinë e palës pronare të truallit, sipas Kontratës së Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.8.2007, të lidhur me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k.

**iii)** FSHU-ja<sup>2</sup> konfirmon se me gjeneralitetet A. C., referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent, me Kontratë Furnizimi nr. \*\*\*, datë 17.7.2009, në instancën Tiranë.

**19.4** *Trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ. Për sa kohë ka rezultuar se pasuria apartament është në pronësi të shtetasit A. C. dhe është krijuar shumë kohë përpara fillimit të detyrës nga*

<sup>1</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2021, të ASHK, DV Tirana Veri.

<sup>2</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, të FSHU, OSHEE Group, dosja e hetimit.

*subjekti i rivlerësimit, nuk janë vërejtur problematika, të cilat mund të përbëjnë indicie për hetim të mëtejshëm, në kuadër të procesit të rivlerësimit.*

**20. Automjet tip veture “Mercedes-Benz 201”**, 4+1, vit prodhimi 1988, me targë \*\*\*, blerë sipas Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.9.2003. Burim krijimi: kursimet e punës si gazetar. Vlera: 200.000 (dyqind mijë) lekë. Pjesa takuese:100% .

**20.1** Subjekti deklaroi faktin se nga ana e punëdhënësit, periudha e punës korrik 2002 – dhjetor 2003 nuk është deklaruar pranë organeve shtetërore, fakt për të cilin është vënë në dijeni përpara dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

**20.2** Nga vlerësimi i dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>3</sup>, deklarimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave, trupi gjykues vlerëson se ato janë në harmoni me njëra-tjetrën, duke mos konstatuar problematika për këtë pasuri në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

## **21. Llogari bankare**

**21.1 Llogari rrjedhëse në BKT**<sup>4</sup>, e cila konfirmon se z. Aurel Celibashi ka çelur llogari pranë kësaj banke dhe gjendja e llogarisë në datën e deklaramit rezultoi në vlerën 33.53 (tridhjetë e tre e pesëdhjetë e tre te qindtat) lekë.

**21.2 Llogari rrjedhëse në Credins Bank**<sup>5</sup>, e cila konfirmon se z. Aurel Celibashi ka çelur pranë saj llogari page në datën 28.5.2008 dhe gjendja e llogarisë në datën e deklaramit rezultoi në vlerën 39.84 (tridhjetë e nëntë e tetëdhjetë e katër të qindtat) lekë.

**21.3 Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank**<sup>6</sup>, e cila konfirmon se z. Aurel Celibashi ka çelur llogari në datën 25.1.2011 në këtë bankë dhe gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 rezultoi në vlerën 5.69 (pesë e gjashtëdhjetë e nëntë të qindtat) lekë.

**21.4 Llogari rrjedhëse në Tirana Bank**<sup>7</sup>, e cila konfirmon se z. Aurel Celibashi ka pasur llogari pranë kësaj banke, në monedhën lekë dhe aktive për periudhën 2007 – 2014, aktualisht e mbyllur.

**21.5** Trupi gjykues vëren se lidhur me pasuritë “llogari rrjedhëse” në emër të subjektit të rivlerësimit, deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga bankat, duke mos rezultuar problematika, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

## **GJETJE TË TJERA**

**22.** Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit deklaroi se së bashku me të dy prindërit ka bërë shpenzime për blerjen e një apartamenti të ndodhur në kompleksin “\*\*\*\*” në Tiranë, si dhe blerjen e automjetit tip “BMW X5”, vit prodhimi 2004. Komisioni hetoi lidhur me këtë deklaram, nga ku rezultoi se të dyja pasuritë e sipërcituara janë krijuar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, e konkretisht:

**22.1 Automjeti tip “BMW X5”.** Referuar informacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>8</sup> rezultoi se automjeti tip “BMW X5”, 3.0 D, me targë \*\*\*, vit prodhimi 2004, është në pronësi të subjektit të rivlerësimit prej datës 22.5.2018. Ai e ka blerë automjetin nga shoqëria italiane “\*\*\*\*” s.r.l., sipas faturës datë 23.4.2018, në vlerën 5.800 (pesë mijë e tetëqind) euro. Mjeti

<sup>3</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2021, dosja e hetimit.

<sup>4</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2017 dhe seksionin 4/3, dosja ILDKPKI.

<sup>5</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.4.201, dosja e hetimit.

<sup>6</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2021, dosja e hetimit.

<sup>7</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2021, dosja e hetimit.

<sup>8</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2021, dosja e hetimit.

është zhdoganuar në datën 6.5.2018, në vlerën 5.800 (pesë mijë e tetëqind) euro, me kurs këmbimi 128,74 dhe shumën 154.487 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë taksë doganore, në total 901.179 (nëntëqind e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë. Sipas regjistrimit elektronik të sistemit të AMF-së, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë mbajtës i policës së sigurimit TPL nga data 22.5.2018 e në vijim.

**22.1.1** Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit shpjegon se pagesa 5.800 (pesë mijë e tetëqind) euro për këtë pasuri është realizuar nga subjekti i rivlerësimit duke i transferuar shoqërisë italiane shumën 3.000 (tre mijë) euro nëpërmjet llogarisë së tij në BKT dhe pjesa tjetër prej 2.800 (dy mijë e tetëqind) euro i është dhënë *cash* transportuesit të mjetit. Bashkëlidhur, subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues për burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe pagesën e saj: (a) mandat tërheqje nga llogaria e pagës në BKT, në emër të z. Aurel Celibashi në datën 10.1.2018, në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë; (b) mandat tërheqje nga llogaria e pagës në Raiffeisen Bank, në emër të z. A. C., në datën 23.4.2018, në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë; (c) mandate këmbimi të \*\*\*, në monedhën euro, datë 21.4.2018 nga z. A. C. ; (ç) mandat depozitimi në llogari nga z. Aurel Celibashi dhe transferim i shumës 3.000 (tre mijë) euro nëpërmjet llogarisë në BKT, në llogari të përfituesit “\*\*\*\*” s.r.l., me referencë pagesë për blerje automjeti, si dhe mandatpagesë zhdoganimi datë 6.5.2018, në Credins Bank, në shumën 157.400 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.

**22.1.2** *Trupi gjykues lidhur me pasurinë automjet tip “BMW X5” vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se automjeti tip “BMW X5” rezulton pasuri e krijuar nga subjekti i rivlerësimit pas dorëzimit të deklaratës Vetting dhe se nuk vërehen rrethana specifike, që mund të përbënin indicie me interes për procesin e rivlerësimit.*

**22.2 Apartamenti 2+1, në rrugën “\*\*\*\*”, në Tiranë.** Nga aktet e administruara gjatë hetimit ka rezultuar se në datën 30.11.2017, sipas Kontratës Noteriale të Porosisë “Për blerje apartamenti”, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., midis palëve kontraktuese, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasve A. C. , A. C. e Aurel Celibashi, në cilësinë e palës blerëse, është nënshkruar kontrata e porosisë për sendin e ardhshëm, apartament nr. \*\*\*, kati \*\*\*, shk. \*\*\*, kulla nr. \*\*\*, me sipërfaqe ndërtimi në total 104.8 m<sup>2</sup>, i përbërë nga 94.3 m<sup>2</sup> sipërfaqe apartamenti e 10.5 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët.

Vlera e shitjes së pasurisë është 89.000 (tetëdhjetë e nëntë mijë) euro dhe mënyra e pagesës është dakordësuar të paguhet në dy këste, përkatësisht 49.000 (dyzet e nëntë mijë) euro (kësti i parë) dhe 40.000 (dyzet mijë) euro (kësti i dytë), duke parashikuar që:

**a)** Kësti i parë të paguhet ditën e nënshkrimit të kontratës, përmes transfertës bankare, ku shuma prej 27.000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) euro do të kalojë në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. në valutën euro, ndërsa pjesa tjetër prej 22.000 (njëzet e dy mijë) euro do të paguhet e konvertuar në valutën lekë (e barasvlefshme me 2.932.600 lekë).

**b)** Kësti i dytë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) euro është parashikuar të paguhet nëpërmjet kredisë bankare brenda muajit tetor 2018.

**22.2.1** Rezulton se në datën 30.11.2017, nëpërmjet BKT-së, nga llogaria e shtetasve A. C. janë kryer dy transfertat bankare, duke transferuar në llogari të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. shumën 27.000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) euro dhe shumën 2.932.600 (dy milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind) lekë.

**22.2.2** Lidhur me shlyerjen e kështit të dytë të blerjes së apartamentit rezulton se sipas Kontratës “Kredi bankare hipotekore” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.11.2018, BKT-ja, në cilësinë e kredidhënësit, ka nënshkruar dhënien e kredisë në shumën 5.100.000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë, për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit, me kredimarrës subjektin e rivlerësimit dhe prindërit e tij në cilësinë e dorëzanësit.

**22.2.3** Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se kjo pasuri nuk ka qenë pjesë e deklaratës Vetting të subjektit të rivlerësimit, pasi është përfituar pas plotësimit të saj dhe se nuk paraqet indicie për hetime të mëtejshme, të cilat do të ishin me rëndësi për procesin e rivlerësimit.

**23. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar me balancë pozitive.**

**24.** Nga hetimi nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* për pasuri të tjera të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të, të padeklaruara prej tij.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

**25.** Në përfundim, trupi gjykues, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, se ai ka kryer deklaram që është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**26.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, ky institucion, në datën 21.12.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Aurel A. Celibashi.

**27.** Komisioni ka kërkuar përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

**28.** Në vijim, Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së deklasifikimin e raportit të vlerësimit për këtë subjekt, të cilin ajo e ka deklasifikuar plotësisht e në të cilin ka konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për z. Aurel Celibashi.

**29.** Gjatë procesit të hetimit administrativ Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit Aurel Celibashi.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

**30.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaramen për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i

rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

**31.** Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Aurel Celibashi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**32.** Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë Gjykatave Administrative kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**33.** Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Aurel Celibashi është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga KLGJ-ja, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, në përshkrimin dhe analizimin e 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dokumenteve ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së, si dhe rezultateve të testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

**34.** Lidhur me analizimin e dokumenteve ligjore të përgatitura nga ndihmësit ligjorë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë<sup>9</sup> informon se për sa i përket dokumenteve ligjore të përgatitura nga ndihmësit ligjorë, ato nuk disponohen në dosje, pasi marrëdhënia midis gjyqtarit dhe ndihmësve përkatës nuk ka qenë e rregulluar me udhëzim apo rregullore të posaçme. Aktet procedurale të dosjes, përfshirë vendimet gjyqësore, duhet të nënshkruhen vetëm nga gjyqtari dhe jo nga ndihmësi.

**35.** Trupi gjykues vëren se mungesa e një kuadri ligjor apo nënligjor për të normuar, dokumentuar apo gjurmuar punën e kryer nga ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative nuk mund të penalizojë këta të fundit dhe nuk mund të vihet në diskutim kontributi që ndihmësit ligjorë kanë dhënë në mbarëvajtjen e punës pranë gjyqtarëve që kanë asistuar.

**36.** Në lidhje me njohuritë ligjore të zotëruara nga z. Aurel Celibashi, të konstatuara nga tetë dokumentet ligjore të vlerësuara, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit, si dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura prej tij, konkludohet se subjekti i rivlerësimit në projektvendimet e përpunuara prej tij manifeston njohuritë e duhura ligjore për të prezantuar saktë çështjen objekt gjykimi, duke identifikuar drejt legjislacionin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes dhe përgatitjen e projektvendimit në përputhje me udhëzimet e gjyqtarit që ai ka asistuar. Gjithashtu, spikasin njohuritë e tij në drejtim të njohurive ligjore, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin e zbatueshëm dhe identifikimin saktë konfliktin e normave ligjore.

### **REZULTATET E TESTIMIT PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

**37.** Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë pranë Komisionit rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>9</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.



**38.** Nga verifikimi i rezultateve të miratuara të testimi profesional rezulton se në fazën e parë të testimi të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit ka fituar 38 pikë nga 100 pikët maksimale, ndërsa në fazën e dytë të testimi subjekti i rivlerësimit ka fituar 111 pikë nga 200 pikët maksimale, duke mos arritur të paktën 60% të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës.

**39.** Duke qenë se testimi pranë Shkollës së Magjistraturës është në vetvete njëri prej kriterëve të vlerësimit *ex officio* të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se subjekti ka përfituar një vlerësim, i cili nuk e pengon subjektin e rivlerësimit për të vijuar ushtrimin e detyrës së ndihmësit ligjor.

**40.** Trupi gjykues vëren gjithashtu se lidhur me aftësitë dhe eksperiencën profesionale të subjektit të rivlerësimit Aurel Celibashi mbi plotësimin prej tij të përvojës së kërkuar për ushtrimin e detyrës së ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar kriteret e parashikuara nga ligji për t'u emëruar dhe për të ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

## **ANKESA/DENONCIME**

**41.** Nga verifikimi i regjistrit të denoncimeve nuk rezulton që të jenë depozituar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ankesa apo denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit Aurel Celibashi, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Vlerësim i kriterit të aftësive profesionale**

**42.** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, duke qenë se testimi pranë Shkollës së Magjistraturës së bashku me relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura shërbejnë në mënyrë kumulative për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga analiza në tërësi e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në ushtrimin e detyrës dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme, duke arritur nivelin kualifikues të kërkuar nga neni 59 i ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e aftësive profesionale.

**43.** Në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të nenit 59, pika 1, shkronja “c”, trupi gjykues e konsideron subjektin e rivlerësimit “të aftë” në kryerjen e funksionit të ndihmësit ligjor.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aurel Celibashi, ndihmës ligjor, aktualisht pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 28.3.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Firdes SHULI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*